

**UNIVERSITETI AAB**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE**

**Departamenti i Përkujdesjes dhe**  
**Mirëqenies së fëmijëve**

**Ligjerata I**

**Programi I lendes(Sylabusi)**

**Lënda: METODIKË E MËSIMDHËNIES**

**VITI AKADEMIK 2014/2015**

**Bartesi, Prof.dr.Fadbi Osmani**

## **QËLLIMI I KURSIT:**

- Që studentëve të ju mundosojë për të mësuar dhe praktikuar aftësi dhe kompetenca të mësimdhënies efektive në nivelin e fëmijërisë së hershme;
- Kërkimin e përmbajtjeve aktuale në sferën e mësimdhënies për zhvillimin e kësaj periudhe të rëndësishme;
- Shqyrtimin e metodave të ndryshme mësimore që duhet të përdoren për të mësuarit e fëmijëve të vegjël;
- Identifikimin e burimeve relevante të cilat dhe të mundësojnë kërkim sistematik të informacioneve që ofrojnë mjetet elektronike bashkëkohore.

## **ÇKA TRAJTON METODIKA E MËSIMDHËNIES:**

- Zhvillimin e fëmijës deri në moshën gjashtë vjeçar, i cili duhet të jetë sa më i suksesshëm;
- Aspektet e përgjithshme dhe të veçanta të punës edukative, në krijimin e konceptit të qartë mbi zhvillimin e hershëm;
- Filozofinë e edukimit parashkollor, në hap me të ariturat shkencore dhe praktikat e avansuara, në përputhje me rethanat dhe synimet e vendit.
- Edukimin parashkollor që paraqet qëndrimin se edukimi është proces që nis me jetën e fëmijës dhe vazhdon në periodat pasuese jetësore;
- Respektimin e karakteristikave të përgjithshme të moshës parashkollore;
- Respektimin e dallimeve individuale midis fëmijëve, me potencialin e tyre gjenetik;
- Cilësitë dhe tempon e zhvillimit, specifikat në të nxënit, niveli dhe cilësitë e paranjohurive, shkathtësive dhe shprehive.
- Zhvillimin e fëmijës sipas fushave të aktiviteteve;
- Nxënien e fëmijëve dhe intelegjencat e shumëfishta;
- Standardet e edukimit parashkollor;
- Kurikula e edukimit parashkollor;
- Metodatat filozofike të të mësuarit, “ *Me fëmijën në qendër*”;
- Metodatat e zhvillimit të fëmijërisë së hershme;

- Modele të punës sipas programeve;
- Procesi i vlerësimit në fëmijërinë e hershme.

### **QËLLIMET E EDUKIMIT PARASHKOLLOR JANË:**

- Zhvillim i tërësishëm i personalitetit të fëmijës dhe shfaqjes maksimale të aftësive;
- Zhvillimi dhe formësimi i individit të përgjegjshëm, aktiv e ndërveprues;
- Zhvillimi i kompetencave komunikuese, shprehisë vepruese dhe ndërvepruese;
- Zhvillimi i aftësive njohëse, emocionale, shoqërore, dhe psikomotore;
- Fëmija i lumtur, i aftë për tu përballuar me sfidat e jetës.

### **PRITSHMËRITË:**

#### ***- Me mbarimin e kursit studentët duhet:***

- Të kuptojnë konceptin e fëmijërisë së hershme – rëndësinë e edukimit parashkollor;
- Të përdor me sukses metodat e mësimdhënies në të nxënit e fëmijëve;
- Të respektoj diversitetin e fëmijëve, individualitetin dhe qasjen gjithpërfshirëse;
- Të planifikojë mësimdhënie që artikulon synime të qarta të të mësuarit.
- Të planifikoj strategji të duhura të vlerësimit që begatojn dhe avansojn mësimin e çdo nxënësi;
- Të përdor teknologji adekuate mësimore për ti bërë përmbajtjet e kuptueshme;
- Gjithmonë të krijoj mjedis pozitiv dhe të sigurt të të mësuarit;
- Të reflektojë me praktikën mësimore, të përmirësoj performancën e mësimdhënies, të marrë përgjegjësi profesionale si pjestar aktiv i komunitetit.

Fjalët më të lakueshme ( kyçe) :

#### **( PËRKUJDESJE – MIRËQENIE )**

▪ *Metodë, metodologji, mësimdhënie, mësimnxënie, edukatë, edukim, fëmijëri, zhvillim i hershëm, edukator, institucion parashkollor, kurikul, standard, aritje, pritshmëri, performanc, kompetencë, vlerësim.*

**UNIVERSITETI AAB**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE**

**Departamenti i Përkujdesjes dhe  
Mirëqenies së fëmijëve**

**Ligjerata II**

**Tema: Kuptimi mbi fëmijërinë e hershme  
dhe metodat e mësimdhënies  
(skica ligjerimi)**

**Mësimdhënësi: Prof.dr. Fadbi Osmani**

## **Nevojat e fëmijëve janë të shumta, në mesin e të cilave të veçonim:**

- nevoja për ushqim;
  - për kujdes shëndetësor;
  - nevojë dhe të drejt për dashuri, ndërveprim, siguri, nxitje dhe mundësi për të mësuar;
- ( këto paraqesin edhe si të drejta themelore për fëmijët )

## **Ç’kuptojmë me fëmijëri të hershme:**

- periudhën e jetës prej lindjes e deri në nisjen në shkollë;
- periudhën që i serviret nga të riturit, sipas koncepteve të tyre, dhe parashikimeve të tyre, çfar dëshirojnë për fëmijën e tyre;
- periudhën që përkon me ritjen dhe zhvillimin më të madh të trurit të fëmijës dhe fitimin e aftësive dhe shprehive bazë, e të domosdoshme për moshën shkollore.

## **E një rëndësie të veçant është se:**

- fillimi i mirë dhe i mbarë i fëmijës në jetë varet nga cilësia e viteve më të hershme të jetës dhe është bazë (themelore) mbi të cilën ndërtohet zhvillimi i mëtejshëm i fëmijës;
- **termet:** kujdes për fëmijën, edukim, zhvillimi normal;
- kujdesi përveç tjerash nënkupton edhe zhvillimin e fëmijës në aspektin **social, emocional, dhe intelektual.**

## **Me zhvillimin e fëmijës nënkuptojmë:**

- zhvillimin e fëmijës, që gjithmon duhet dalluar nga procesi i ritjes së fëmijës;
- zhvillimi paraqet një kuptim më të gjerë;
- zhvillimi përfshin të mësuarit e funksioneve të shumta në mënyra të reja, dhe më të ndërlikuara;
- zhvillimi përfshin edhe procesin e të nxënimit, procesin e përfitimit të njohurive, shprehive dhe vlerave.

**Drjetimet kryesore të zhvillimit normal të fëmijëve janë:**

- **zhvillimi fizik:** ( aftësia për lëvizje dhe kordinimin e lëvizjeve);
- **zhvillimi social:** ( aftësia për të hyrë dhe krijuar mardhënie me të tjerët );
- **zhvillimi intelektual:** ( aftësi për të menduar );
- **zhvillimi gjuhësor:** ( aftësi për të shprehur dhe për të komunikuar me bashkëmoshatarët dhe të riturit).

**PRA:**

*Zhvillimi i fëmijës ndryshon, jo vetëm nga njëri fëmijë në tjetrin, por edhe nga njëra kulturë në tjetrën. Për arsye të ndryshimeve individuale dhe ndryshimeve kulturore.*

**Shkaqet dhe arsyet për investim në fëmijërinë e hershme:**

- **investimi me qëllim të parandalimit të problemeve të zhvillimit të fëmijëve dhe përfitimeve më të qëndrueshme të individëve dhe shoqërisë;**
- **investim në vitet e para të zhvillimit të fëmijës në vitet e para, në veçanti në zhvillimin e intelegjencës, personalitetit, dhe mënyrën e të sjellurit.**

**Ndërsa argumentet kryesore për investime në zhvillimin e hershëm janë:**

- **Argumenti ekonomik;**
- **Argumenti i barazisë sociale;**
- **Argumenti i barazisë gjinore;**
- **Argumenti i vlerave humane;**
- **Argumenti i të drejtave të fëmijës.**

**Karakteristikat e zhvillimit të fëmijëve:  
( periudha 3-5-6 vjeçe)**

- zhvillimi i fëmijës, që do të thotë pranimi i tërësisë së njohurive reth mënyrës së ritjes dhe nxënjes së fëmijës;
- zhvillimi i fëmijës që nënkupton zhvillimin e fushave socio-emocionale, fizike, intelektuale dhe gjuhësore;
- zhvillimi i fëmijës sipas ritmit individual, njohja e çdo fëmije, dhe vlersim i karakteristikave të veçanta që paraqet fëmija;
- Faktorët kryesor që ndikojnë në ritjen dhe zhvillimin e fëmijës janë: a) Gjenet dhe b) Mjedisi

**Ndërsa nevojat për zhvillimin e fëmijëve janë:**

- Nevoja për marjen e besimit dhe sigurisë së nevojshme prej të riturve;
- Nevoja për të njohur dhe për të arsytuar, dhe për të zgjidhur probleme;
- Nevoja për të qenë krijues;
- Nevoja për veprimtari të ndryshme fizike;
- Nevoja për shkëmbim përvoja me fëmijët e tjerë dhe të ritur;

**Shih për këtë më gjërësisht: Lefter Selmani, Aurela Zizi, *Konceptimi dhe organizimi i veprimtarisë mësimore-edukative në arsimin parashkollor.***

- *Të mësuarit nëpërmjet lojës dhe mënyra më e përshtatshme sipas së cilës fëmijët mësojnë, prandaj metodat dhe teknikat që përdor edukatori jepen nëpërmes lojës.*

**Ndërsa metodat dhe teknikat më të përshtatshme në edukimin e periudhës parashkollore janë:**

- Biseda: ( flitet për një temë ose çështje të caktuar);
- Shpjegimi: ( shpërndarja e informacionit tek fëmija);
- Demonstrimi: ( ilustrimi i një çështje me shembuj konkret);
- Ekskursioni: ( Ku fëmijët kanë mundësi të njohin objekte, dukuri, procese të mjedisit);

- **Të pyeturit:** ( nxitja e të menduarit tek fëmijët );
- **Stuhia e mendimeve:** ( mbledhja e ideve dhe mendimeve të ndryshme );
- **Pema e mendimeve:** ( dhënia e mendimeve të lidhura në mes veti );
- **Dialogu:** ( mundëson të nxënit aktiv tek fëmijët); etj.

( Ne ligjerate te vecant do te diskutohet ne menyre te specifikuar per metodat.teknikat dhe strategjite e mesimdhenies ne ed. Parashkollor)



**UNIVERSITETI AAB**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE**

**Departamenti i Përkujdesjes dhe  
Mirëqenies së fëmijëve**

**Ligjerata III**

**Tema: Zhillimi i fëmijëve sipas fushave të  
zhvillimit  
(skica ligjerimi)**

**Mësimdhënsi: Prof.dr. Fadbi Osmani**

## **Karakteristikat zhvillimore të fëmijëve të moshës ( 3-4-5 vjeç)**

- **hyrja ne periudhën e fëmijrisë së hershme (kalimi prej foshnjërisë në fëmijëri);**
- **bëjnë hapa më të mëdhenjë në zhvillimin e tyre, duke shprehur interesim sidomos për botën që i rethon;**
- **pak nga pak fillojnë të shkëputen nga prindërit e tyre;**
- **karakteristikë e rëndësishme është fillimi i të folurit;**
- **viti i katërt (karakteristikë shumë e rëndësishme), e njohur si mosha e fjalës;**
- **fëmijët e kësaj moshe shfaqin ndjenja frike, duan të luajn, të kënaqen me veprimtari fizike;**
- **fëmijët në të shumtën e rasteve dëshirojnë të prekin, shijojnë, të nuhasin, të dëgjojnë, janë më të etur për të mësuar, pra mësojnë duke provuar dhe duke bërë diçka;**
- **fëmijët vijnë nga mjedise të ndryshme , nga ndarja me prindërit dhe të tjerë të rëndësishëm për ta, paraqitja e vështërsive në krijimin e raporteve të reja me shokë të rinj etj;**

**Zhvillimi i fëmijëve bëhet nëpërmes fushave:**

**(këto fusha zhvillimi janë të ndërlidhura njëra me tjetrën)**

- **Zhvillimi socio-emocional;**
- **Ka të bëjë me aftësit e fëmijëve për të ndihmuar veten dhe vetëkontrollin, zhvillimin e ndjenjave dhe emocionet, ndërveprim me të tjerët-me fëmijët tjerë dhe të riturit;**
- **fitmi i shprehive që risin vetëndërgjegjësinë dhe vetëkontrollin;**
- **fëmija në këtë mosh gradualisht mëson vlerat humane nëpërmjet mardhënieve me të tjerët;**
- **fëmijët krijojnë modelet e para, duke parë, duke dëgjuar, dhe duke diskutuar me të riturit;**

### **Zhvillimi fizik (karakteristikat):**

- Lëvizjet motorike, vendoshmëria për të zbatuar lëvizje vrapimi, hedhje e topit etj;
- fëmijët e moshës katër vjeçare me lehtësi i kthejnë në shprehi veprimet e bëra në moshën tri vjeçare;
- në këtë moshë fëmijëve më së shumti u pëlqen të jenë në shoqëri me të tjerët dhe të bashkëpunojnë;
- në lojë janë aktiv, por edhe aq agresiv (loja përcjellet me materiale të ndryshme për formimin e objekteve);
- Fëmijët e moshës pesë vjeçare tani, mund të vishen edhe zhvishen vetë pa ndihmën e tjerëve, mbajnë mjete të ndryshme, dhe në veçanti si karakteristike është mbajtja e mirë e lapsit në dorë;
- fëmijëve u pëlqen të zbërthejnë dhe mbërthejnë robotat, ti zgjidhin këpucët, por jo edhe ti lidhin, kordinojnë drejt lëvizjet e duarve dhe këmbëve etj;

### **Fusha intelektuale e zhvillimit karakterizohet:**

- Me zhvillimin e aftësive për të nxënë dhe për të zgjidhur probleme;
- fëmijët fitojnë përvoja dhe aftësi analitike, vëzhguese, klasifikojnë objektet sipas cilësive fizike, emërtojnë dhe shpjegojnë vizatime që kanë kuptim për ta;
- Tregojnë emrin e plotë të tyre, moshën, zhvillojnë veprimtari në periudha më të gjata kohore 5-15”;
- Arijnë të dallojnë kohët (të tashmen nga e kaluara), parashirojnë pyetje, kërkojnë informacione të reja nga rethi që i rrethon, dallojnë ngjyrat, kuptojnë urdhërat.

### **Zhvillimi gjuhësor dhe komunikimi:**

- zhvillimi (fitimi) i aftësive për të kuptuar dhe për të përdorur gjuhën;
- fëmijët në këtë periudhë janë shumë aktiv në mësimin e gjuhës;
- të mësuarit për të shkruar fillon me të mësuarit e shprehjeve, shprehjet motorike, mbajtja e lapsit, dhe fillon të ngjyros brenda vijave.

- fëmija zakonisht vizaton figura që paraqesin njerëz, kafsh dhe sende të ndryshme;
- fëmija përdor gjuhën jo vetëm për të biseduar, por edhe për të shkëmbyer informacion;
- fëmijët 5-vjeçar, kanë një gjuhë të pasur dhe të rrjedhshme, dhe janë në gjendje të japin përgjigje të tipeve të ndryshme;
- fëmija 5-vjeçar poashtu është në gjendje të përshkruaj çka ka ndodhur gjatë ditës.

*Fëmijët nuk duhet qortuar kur shqiptojn apo thone fjalët gabim. Rruga më e mirë dhe më e drejtë është shqiptimi i saktë i fjalëve nga i rituri (edukatori-prindi, kujdestari dhe të tjerët)*

*Ne shpesh në rolin e prindit, edukatorit ose të tjerëve, shqetësohemi apo brengosemi se çfar do të bëhet një fëmijë nesër, duke haruar se ai është dikush sot.*

*Fjalët më të lakueshme për prindërit në lidhje me zhvillimin e fëmijës janë:*

- *A është i shëndetshëm fëmija im? (kujdesi i shëndetit të fëmijës, të ngrënit, kujdesi për gojën, përdorimi i duarve dhe i gishtërinjëve);*
- *A është i lumtur fëmiju im? (komunikimi dhe mardhëniet me të tjerët);*
- *A po zhvillohet normalisht? (zhvillimi emocional, kognitiv dhe gjuhësor);*
- *A po bëjë atë që duhet bërë unë si prind? ( dilema e prindërve reth edukimit të fëmijëve në bazë të stileve të ndryshme të edukimit).*

***UNIVERSITETI AAB***  
***FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE***  
***Departamenti i Përkujdesjes dhe***  
***Mirëqenies së fëmijëve***

***Ligjerata IV***

***Tema: Zhvillimi i fëmijëve sipas fushave të***  
***zhvillimit të edukimit artistik, figurativ,***  
***matematikor, etj.***  
***(skica ligjerimi)***

***Mësimdhënsi: Prof.dr. Fadbi Osmani***

*Lojrat dhe kategorizimi i tyre sipas fushave të zhvillimit:*

- *Loja paraqet mjetin më të fuqishëm, veprimtari të rëndësishme në jetën e fëmijëve, loja është përpjekje e madhe për të fituar, në disa raste bëhet më e rëndësishme se ushqimi dhe gjumi;*
- *Loja paraqet “punë” dhe “detyrim” për fëmijët, puna si lojë dhe loja si punë, sepse nëpërmjet lojës fëmijët, njohin botën e jashtme dhe të brendëshme;*
- *Loja mundëson të shprehurit e ndjenjave dhe emocioneve, se sa të shprehurit me fjalë.*

*Sipas psikologut Zhan Pijazhe, fëmija aktivitetin e vetë e përvijon nëpërmes 3 llojeve të lojrave:*

- *Loja praktike, e cila përfshin aktivitetin kërkues, lëvizjeve (sensomotorike) që karakterizohet nga mosha 6 muaj e deri 2 vjeç;*
- *Loja simbolike, e cila ka për qëllim zhvillimin e fantazisë tek fëmijët, përmes imitimit, e që karakterizohet pas moshës 2 vjeçare;*
- *Lojrat me rregulla, karakterizohet në moshën 5-6 vjeçare, këto lojra bëhen në bazë të rregullave të caktuara ku fëmija pretendon të bëjë, gjoja është dikush etj.*

*Loja mundëson zhvillimin e fëmijëve nëpërmes shumë fushave:*

- *zhvillimin fizik dhe shëndetësor;*
- *zhvillimin socioemocional;*
- *zhvillimin intelektual dhe gjuhësor;*
- *zhvillimin artistik-muzikor;*
- *zhvillimin figurativ;*
- *zhvillimin matematikor, etj.*

*Zhvillimi (edukimi) artistik, muzikor dhe figurativ, objektivat kryesore:*

- *Fëmiu të aftësohet për komunikim emocional pozitiv me artin;*
- *Të pasuroj gjuhën e të shprehurit;*
- *Të njohë dhe të përvetësoj fjalorin themelor të arteve të ndryshme;*
- *Të njohë mjetet themelore të arteve dhe të krijoj shkathtësitë dhe shprehitë elementare të përdorimit të tyre;*
  
- *Të nxis zhvillimin e aftësive estetike-shijes-estetike;*
- *Të aftësohet ti shpreh perceptimet, mendimet dhe ndjenjat përmes aktiviteteve estetike-artistike dhe të komunikojë me të tjerët përmes tyre;*
- *Të aftësohet për pjesëmarrje të vazhdueshme aktive individuale dhe grupore në forma të ndryshme të komunikimit dhe shprehjes.*

*Edukimi muzikor-detyrat-aktivitetet-pitshmëria, (mosha 3-4 vjeç):*

*1. Detyra (objektivat) e veçanta: fëmija ti dëgjoj dhe ti përjetoj tingujt dhe zërat e natyrës:*

*2. Aktivitetet e fëmijës: fëmija shfrytëzon situatat e përditshme në të cilat percepton zëra, tinguj nga mjedisi jetësor, dëgjojnë zërat e shpezëve dhe të kafshëve, zhvillon aktivitete muzikore përmes të cilave fëmija kënaqet duke dëgjuar, fëmija më pastaj imiton tingujt dhe zëra nga natyra dhe mejdisi:*

*3. Pritshmëria-rezultatet:*

- *fëmiu dëgjon dhe përjeton zëra dhe tinguj;*
- *fëmiju gradualisht tregon kureshtje për aktivitete muzikore, kënaqet dhe synon ti shpreh emocionet e këndëshme;*
- *fëmiu fillon poashtu gradualisht të degjoj muzikë vokale dhe instrumentale, shpreh ndjenja për ritëm, melodi, harmoni etj.*

***Edukimi muzikor-mosha (grup mosha) 4-5 vjeçar:***

***1. Detyrat: që fëmiju të aftësohet për të dëgjuar muzikë vokale dhe instrumentale, ti njoh veprat muzikore për fëmijë, të zhvilloj aftësi muzikore, ndjenjë, aftësi për imitim etj:***

***2. Aktivitetet: nëpërmes situatave të përditshmërisë shfrytëzon përceptimin e zërave dhe tingujve, fëmija ndëgjon në mënyrë aktive, përjeton kompozimet muzikore, këndon, interpreton, luan me mjete dhe vegla muzikore.***

***Rezultatet-pritshmëria:***

- ***dëgjojn muzikë vokale dhe instrumentale, këndon përmbajtje artistike e muzikore, reciton;***
- ***ka ndjenjë për ritëm, melodi, harmoni, njeh veprat muzikore për fëmijë etj;***
- ***jep gjykimet fillastare për vlerat estetike për muzikë.***

***Edukimi figurativ, (mosha 3-4 vjeçe):***

***1. Detyrat-objektivat: të vëzhgoj bukuritë në natyrë, të vëzhgoj dhe të bisedoj për gjësendet e ndryshme, të vëzhgoj për krijimet e artit figurativ, për ngjarjet e përditshme, të knaqet me aktivitetet e artit figurativ etj.***

***2. Aktivitetet e fëmijës: të shëtisë në natyrë, të vëzhgoj, të përceptoj dhe ta përjetoj atë; duke shetituar në natyrë dhe ambiente tjera, shfrytëzon shqisat e ndryshme për ti njohur dhe përjetuar cilësitë e ndryshme, ngjyrën, formën, pozitën, materialin etj; fëmija luan me vija dhe knaqet me aktivitetet e bëra.***

***Rezultatet-pritshmëria:***

***Vëzhgon natyrën mjedisin dhe bisedon për mejtet, materialet që aplikohen në artin figurativ, shpreh qënaqësi gjatë aktiviteteve të artit figurativ, krijojnë produkte të artit figurativ me mjete e materiale të ndryshme; tajojnë shenja simbolike në jetën e përditshme.***



*Grup- mosha 4-5 vjeç dhe 5-6 vjec*

*1. Detyrat e veçanta janë:*

- *që fëmija të vëzhgoj natyrën dhe të komentoj botën e gjallë dhe jo të gjallë;*
- *të vëzhgoj dhe të bisedoj për krijimet artistike (arti figurativ);*
- *të vëzhgoj më thellë mjedisin jetësor;*
- *të vëzhgoj e të bisedoj dhe të shpreh mendimin për krijimet e arteve figurative.*

*2. Aktivitetet e fëmijëve:*

- *fëmija bën aktivitete të mudnëshme në natyrë që të ndjejë hapsirën si pjesë e pandarë e jetës;*
- *bënë aktivitete të ndryshme duke vizatuar, njerëz, bimët, kafshët, gjësendet, shenja dhe simbole etj;*
- *vazhdon aktivitete të vëzhgimit të mjedisit dhe i komenton në bazë të komentimeve personale.*

*Rezultatet-pritshmëria:*

- *vëzhgon natyrën dhe komenton botën e gjallë dhe jo të gjallë;*
- *vëzhgon dhe bisedon për krijimet e artit figurativ;*
- *vëzhgon dhe njeh dallimet midis vetes dhe të tjerëve;*
- *njih dhe identifikon mjetet dhe materialet e artit figurativ;*
- *njih dhe gjykon për veçoritë në krijimet figurative;*
- *shpreh përfytyrimet (figurativisht) nga mjedisi jetësor.*

*Zhvillimi i fëmijëve nga fusha e aktiviteteve në Matematikë (3-4 vjeç):*

*1. Detyrat:*

- *të fillojë të kuptoj dhe të nxënit mbi shprehjet: pak, shumë, lart, posht, përpara, pas, i madh, i vogël, të dijë emrat e numrave;*
- *të aftësohet gradualisht të numroj, të bëjë dallimin në mes numrit dhe numrimit;*
- *gradualisht të mund ti krijoj bashkësitë e gjësendeve dhe gjallesave;*
- *të njohë mardhëniet midis shkaktit dhe pasojës.*

## *2. Aktivitetet e mundëshme të fëmijëve janë:*

- *fëmija përmes aktiviteteve, emërton gjësende të mejdisit sipas dëshirës së vetë dhe me ndihmën e të riturve, duke emërtuar një nga një;*
- *fëmija numëron objektet e ngjashme sipas një veçorie (ngjyrës, formës, madhësisë etj);*
- *fëmija bisedon me të tjerët për karakteristikat fizike dhe gjeometrike të objekteve dhe gjësendeve (ngjyrën, formën, sipërfaqen, madhësin, formën rumbullakët me kënde, e butë, e lëngët, e madhe etj.*

## *3. Rezultatet-pritshmëria:*

- *njuh shprehje matematikore: pak, shum, përpara, pas, i gjatë, i shkurtër, i vogël etj, lart, posht;*
- *është në gjendje të numëroj;*
- *bënë dallimin midis numrit dhe numrimit;*
- *identifikon dhe dallon objektet sipas formës dhe vetive.*

## *Grup-Mosha, 4-5, dhe 5-6 vjeç:*

### *1. Detyrat janë:*

- *të pasurojnë dhe të zgjerojnë shprehjet matematikore;*
- *të krahasojnë elementet bazë të lartësisë, gjerësisë, gjatësisë, peshës etj;*
- *të aftësohet për të shfrytëzuar mënyrat e ndryshme të zgjedhjes së problemeve;*
- *të njoh trupat gjeometrike (kubin, sferën, piramidën etj).*

## ***2. Aktivitetet e mundëshme të fëmijës:***

- ***Në situata të përshtatshme fiton përvojë duke luajtur me mjete të ndryshme, duke i emituar ato, dhe shfrytëzon shprehje matematikore gjatë regullimit të tyre me grupe;***
- ***Numëron në mënyrë suksesive dhe zbrapthi;***
- ***Bisedon për radhitjen e ngjyrave në hapsirë dhe kohë.***

## ***Rezultatet –pritshmëria:***

- ***ka fjalorë më të pasur dhe më të gjerë;***
- ***krahason elementet bazë të lartësisë, gjerësisë, gjatësisë dhe peshës;***
- ***ka fjalor më të pasur matematikor dhe ka krijuar shprehi të shfrytëzimit të tij;***
- ***krahason rezultatet gjatë llogaritjeve etj.***

***UNIVERSITETI AAB***  
***FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE***  
***Departamenti i Përkujdesjes dhe***  
***Mirëqenies së fëmijëve***

***Ligjerata V***

***Tema: TË NXËNIT (mësuarit) e fëmijëve***  
***të moshës 3-5 vjeç – Inteligjencat e***  
***shumëfishta***  
***(skica ligjerimi)***

***Mësimdhënsi: Prof.dr. Fadbi Osmani***

### *Karakteristikat e të nxënit tek fëmijët:*

- *Studimet dhe vëzhgimet e shumta tregojnë se foshnjat dhe fëmijët janë në gjendje të mendojnë dhe të arsyetojnë, janë shumë aktiv në të nxënë dhe në të kuptuar;*
- *studiuesit, shpjegojnë (japin) tri arsye kryesore, në lidhje me aftësit të cilat i determinojnë aftësit e tyre;*
  - *së pari: aftësit dhe të nxënit në mënyrë efektive, është rezultat i trurit, i cili është i ngjashëm me kompjuterin, dhe është i përbërë prej më shumë miliona neurone;*
  - *së dyti: fëmijët zotërojnë prej natyre mekanizma të rëndësishëm për të nxënë;*
  - *së treti: fëmijët mësojnë, sepse prindërit mbështetin dhe çojnë përpara zhvillimin e fëmijëve të tyre në mënyrë të veçant dhe shumë të fuqishme.*
- *Të nxënë sipas disa teorive nuk shifet si diçka individuale që ndodh tek fëmiju, por mbi të gjitha, si një veprim bashkëveprues, ku fëmijët dhe të rriturit i ndërtojnë njohuritë bashkë, sepse kështu ato (njohuritë) marin kuptim;*
- *Të nxënit në fëmijërinë e hershme, loja është mënyra më e mirë për të realizuar të nxënit.*

### *Zhan Piazhe dhe Vigotski theksojnë se:*

- *nëpërmjet motivimit dhe veprimtarisë së lojës fëmiju gradualisht futet në hulumtimin dhe eksperimentim, dhe në këtë aktivitet të mer pjesë një kohë më të gjatë;*
- *egzistojnë lidhje të forta ndërmjet lojrave simbolike dhe zhvillimit të aftësive mendore;*
- *mbështetja e të rriturve është faktor shumë i rëndësishëm në cilësinë e të nxënit.*

*Për Edukatorët është e rëndësishme të dijnë:*

- *Shkallët e zhvillimit të fëmijëve 3-4-5 vjeç, sepse njohja u shërben si piknisje për të njohur, çfar u pëlqejnë fëmijëve, si mund të reagojnë si ti përdorin materialet që zgjedhin, dhe si mund të hynë në mardhënie me të tjerët;*
- *Se fëmijët vijnë në kopsht me një bagazh të vetin njohurish, karakteristikash dhe përvojash, të cilat ndikojnë në përvojën të cilën do e fitojnë në krijimin e mardhënieve me të tjerët, dhe në njohuritë që do të mësojnë;*
- *të njohin çdo fëmijë, për të zhvilluar mësimdhënie të individualizuar, që i përgjigjet zhvillimit që ka secili fëmijë;*
- *planifikimin dhe zbatimin e një programi të përshtatshëm për moshën e fëmijëve 3-5 vjeç;*
- *edukatorët dhe prindërit duhet mirë të njohin karakteristikat e zhvillimit, socioemocional, fizik, kognitiv dhe gjuhësor;*
- *të dy palët (partnerët) duke njohur mirë fëmijët, të ndërtojnë mardhënie dhe të marrin vendime reth mënyrës se do të mbështesin fëmijën, në procesin e të nxënies, që çdo fëmijë të jetë i suksesshëm në kopsht, shkollë dhe mësim, por nënkuptohet brenda mundësive dhe aftësive të tij.*

*“ Shoqëria ( shteti, kombi, komuniteti) mund të vlerësohet, nga qëndrimi që mban ndaj fëmijëve të vegjël, sa investon, çfar u ofron realisht për t’u edukuar”*

*Zhvillimi i fëmijëve sipas fushave zhvillimore (aktiviteteve) për të mësuar dhe si të mësoj, bazohet në intelegjencat e shumëfishta, që sipas psikologut GARDNER janë:*

- *Intelegjenca gjuhësore, e cila përfshin të gjitha format e përdorimit të gjuhës, ndjeshmërisë ndaj gjuhës, fëmijët që kanë këtë intelegjencë e përdorin në mënyrë efektive gjuhën për ta shprehur në mënyrë retorike;*
- *Intelegjenca logjike-matematikore, përfshin aftësin e fëmijëve për të analizuar logjikisht problemet, për të kryer veprime matematikore, sinonim i kësaj është të menduarit kritik, për të menduar në mënyrë racionale;*

- *Inteligjenca trupore-kinestetike, përfshin aftësitë për të përdor trupin, për të shprehur idetë dhe ndjenjat për të krijuar ose shëndruar gjera të ndryshme;*
- *Intelegjenca muzikore, përfshin aftësitë për të kuptuar muzikën, për të gjykuar, për tu shprehur nëpërmjet notave muzikore, për tonacione dhe ritme muzikore. Kjo inteligjencë është shumë e ngjashme me inteligjencën gjuhësore;*
- *Intelegjenca pamore-hapsinore, përfshin aftësitë e fëmijëve që gjithçka që shohin në rethin e tyre, dhe janë të aftë për tu orientuar;*
- *Intelegjenca interpersonale, përfshin aftësitë e fëmijëve për ti kuptuar njerzit, për të bashkëpunuar me ta, për të mësuar prej tyre;*
- *Intelegjenca intrapersonale, përfshin aftësitë për të njohur dhe kuptuar vetveten, si dhe për të gjykuar saktësisht për ndjenjat, frikën dhe motivet personale;*

*- Gardneri, inteligjencat e shumëfishta personale të njeriut i trajtoi si “copa të një të tërë”, që shumë rallë veprojnë në mënyrë të pavarur, ato në të shumtën e rasteve bashkëveprojnë, ato lidhen për të plotësuar njëra tjetrën.*

*Inteligjencat e njeriut janë edhe amorale, sepse ato mund të përdoren si për qëllime të mira poashtu edhe për qëllime shkatëruese.*

*Të nxënit personal, social dhe emocional është aspekti shumë i rëndësishëm i programit për fëmijët e moshës 3-5 vjeç, sepse fëmiju i kësaj moshe krijon kuptimin për botën që e rethon në shoqëri.*

*Zhvillimi gjuhësor ka një rol mbështetës në qartësimin dhe organizimin e proceseve mendore, mundësohet të folurit dhe të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit.*

*Zhvillimi matematikor dë të thotë që fëmijët të mësojnë se numrat mund të përdoren për të emëtuar objekte, për të treguar masë ose sasi.*

*Zhvillimi fizik mundëson që fëmija të mësoj reth trupit të tij, fëmiju teston veten. Sipas psikologut J.Bruner, lëvizja, veprimi dhe loja përbëjnë ato që quhet kultura e fëmijërisë.*

***UNIVERSITETI AAB***  
***FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE***  
***Departamenti i Përkujdesjes dhe***  
***Mirëqenies së fëmijëve***

***Ligjerata VI***

***Tema: Standardet e edukimit parashkollor***  
***(skica ligjerimi)***

***Mësimdhënsi: Prof.dr. Fadbi Osmani***



*Standardet e përgjithshme të edukimit parashkollor për fëmijët e moshës 3-6 vjeç, paraqesin dokument themelor, i cili parashtron kërkesat dhe kriteret që duhet ti respektojnë institucionet parashkollore, në përshtatje dhe harmoni me politikën arsimore të këtij nënsistemi, të sistemit arsimor të shtetit të Kosovës.*

*Hartimi (përpilimi) i standardeve paraqet hapin e parë dhe shumë të rëndësishëm, i cili parashtron kërkesat dhe drejtimet kryesore të veprimtarisë dhe përmbajtjes edukative që ofron institucioni parashkollor për moshën 3-6 vjeçe. PRA – studentët në fakt parashtrajnë kërkesat për të zhvilluar një kurikul apo program, dhe shërben për zhvillimin e fëmijës parashkollor.*

*Standardet ndihmojnë kuptimin që ka edukimi në moshën parashkollore; standardet shërbejnë për të udhëhequr zhvillimin, vlerësimin dhe përmirsimin e veprimtarisë edukative të fëmijëve; standardet synojnë plotësimin e nevojave të fëmijëve dhe sigurojnë përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta së bashku me fëmijët tjerë.*

*Parashtrimi i standardeve është në formën e radhitjes së kërkesave për secilin standard, në këtë mënyrë më lehtë do të bëhet vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm të veprimtarisë edukative të institucionit parashkollor.*

**Çka është në fakt STANDARDI ?**

- *Standardi është kriter sipas të cilit vlerësohen dhe gjykojnë aritjet në procesin e edukimit;*
- *Standardet shërbejnë si mjete për të gjykuar cilësinë e programeve të edukimit parashkollor;*
- *Standardet e aritjeve të fëmijëve;*
- *Standardet për vlerësimin e kompetencës profesionale të edukatorëve;*
- *Standardet për mbarvajtjen e veprimtarisë edukative ku përfshihen mjedisi fizik, kualifikimi i personelit, bashkëpunimi i familjes dhe i komunitetit me institucionin parashkollor.*

*Dallojmë standardet e përmbajtjes dhe standardet e aritjes:*

- *Standardet e përmbajtjes paraqesin tërsinë e njohurive, të aftësive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve që fëmijët duhet ti fitojnë në kopsht, çfar duhet të dinë, dhe çfar janë në gjendje të bëjnë fëmijët e kësaj moshe;*
- *Standardet e aritjes përcaktojnë aftësitë, shprehitë dhe njohuritë që duhet ti fitojnë fëmijët 3-4-5-6 vjeç, të formuluar sipas standardit të përmbajtjes.*

*Fushat kryesore ( më të rëndësishme ) që përmbajnë standardet janë:*

- 1. Bashkëveprimi i edukatorëve dhe fëmijës, qëllimi i kësaj fushe ka të bëjë me bashkëveprimin e edukatorëve dhe fëmijëve, ky bashkëpunim mundëson që fëmijët të njohin veten dhe të tjerët. Bashkëveprimi karakterizohet nga ngrohtësia, kujdesi, respekti dhe përgjegjësia etj.*
- 2. Kurikula, ka për qëllim nxitjen e fëmijëve për ti përfshij në mënyrë aktive në procesin e të nxënës, për të marrë pjesë në veprimtari të ndryshme.*
- 3. Partneriteti familje-institucion parashkollor, kjo fushë ka të bëjë me krijimin e lidhjeve ndërmjet institucionit parashkollor dhe familjeve të fëmijëve. Prindërit duhet të jenë mirë të informuar për programin e edukimit që zhvillon institucioni parashkollor.*
- 4. Kualifikimi i personelit edukativ, paraqet një fushë të rëndësishme, që ka për qëllim cilësinë e personelit edukativ, niveli i lartë i edukatorëve, që përcaktohet nga përgaditja profesionale, përkushtimi në punë dhe figura morale e edukatorit.*
- 5. Siguria, shëndeti dhe ushqimi (standardi i sigurisë, shëndetit dhe ushqimit), kjo fushë ka për qëllim parandalimin e aksidenteve, dhe sumndjeve, të afrohen praktika të sigurt të shëndetshme që sigurojnë zhvillimin moral mendor dhe fizik të fëmijëve.*

*6. Mjedisi fizik, ka për qëllim një sigurim të përshtatshëm për të gjithë fëmijët, përfshirë këtu edhe fëmijët me nevoja të veçanta. Që mjedisi fizik i brendshëm dhe i jashtëm ti përshtatet nevojave dhe interesave të fëmijëve.*

*7. Administrimi-standardi i administrimit, paraqet mënyrën se si administrohet institucioni parashkollor në realizimin e veprimtarisë edukative-raportet që kushtëzohen nga komunikimi korekt midis personelit edukativ me drejtuesit e institucioneve parashkollore.*

*8. Vlersimi-standardi i vlersimit, paraqet vlersim sistematik të procesit të mirëarritjes, mirëgjendjes dhe përkujdesjes së fëmijëve në institucionin parashkollor.*

*Procesi i vlersimit duhet të siguroj përmirësimin e vezhdueshëm të punës dhe plotësimin e nevojave të fëmijëve dhe familjeve të tyre, në përputhje me përpjekjet që bëjnë personeli edukativ. Vlersimi në fakt identifikon pikat e dobëta dhe të forta të punës edukative (vlersimi i brendshëm dhe i jashtëm).*

*Për shembull:*

*a) Standardi i përmbajtjes  
(fusha: Edukimi qytetar)*

*b) Standardi i aritjes  
Jeta e përbashkët në  
kopsht-komunikimi*

*Tu mësoj fëmijëve të  
jetojnë dhe të veprojnë  
së bashku me fëmijët e  
tjerë dhe të riturit*

***UNIVERSITETI AAB***  
***FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE***  
***Departamenti i Përkujdesjes dhe***  
***Mirëqenies së fëmijëve***

***Ligjerata VII***

***Tema: Kurikula e edukimit parashkollor***  
***(skica ligjerimi)***

***Mësimdhënsi: Prof.dr. Fadbi Osmani***

### ***Kurikula përfshinë:***

- ***Programin (qëllimet e programit të edukimit);***
- ***Veprimtarinë edukative;***
- ***Metodologjinë e punës;***
- ***Mjedisin ku zhvillohet procesi edukativ – mësimor.***

### ***Qëllimi i kurikulës është:***

- ***Zhvillimi tërësor i personalitetit të fëmijës, potencialit dhe shfaqjes maksimale të aftësive të tij;***
- ***Zhvillimi dhe formësimi i individit të lirë, të përgjithshëm, aktiv e ndërveprues;***
- ***Zotërimi i aftësive dhe kompetencave komunikuese, shprehëse, logjike dhe vepruese e ndërvepruese;***
- ***Zhvillimi dhe përvetësimi i aftësive njohëse, efektive-emocionale, morale dhe psikomotore;***
- ***Respektimi i barazisë së shanseve edukative për të gjithë fëmijët;***
- ***Fëmija i lumtur, i aftë për tu përballuar me sifidat e jetës.***
  
- ***Nxitjen e fëmijës të mësoj dhe të zhvilloj aftësitë dhe shprehitë bazë;***
- ***Të ndërtuarit dhe të udhëhequrit e energjive të brendshme; edukimin e fëmijërisë së hershme përmes lojës (loja paraqet zemrën e edukimit), loja është „puna” e fëmijëve (Frebeli 1876);***
- ***Loja ofron mundësi reale për zhvillimin intelektual, motivon, nxit, përqendron, zgjidhë probleme);***
- ***Loja mundëson formimin e shprehive sociale: (komunikimin, të inkuadruarit në bisedë, bashkëpunimin me fëmijë tjerë dhe të rritur).***

*Kurikula do të jetë cilësore dhe efikase atëherë:*

- *Kur do të nxisë fëmijët të jenë aktiv në veprimtari të ndryshme;*
- *Kur qëllimet janë të qarta për të gjith fëmijët;*
- *Kurikula ndërtohet mbi njohuritë dhe përvojat e mëparshme;*
- *Kurikula hartohet që çdo fëmijë të ketë sukses.*

*Synimi i programit edukativ (qëllimi) është:*

- *Zhvillimin e besimit në vetëvete dhe aftësitë për të nxënë;*
- *Zhvillimin e aftësive për të qenë i vëmendshëm;*
- *Aritjen e marrëdhënieve dhe raporteve pozitive në mes të rriturve dhe fëmijëve;*
- *Zhvillimi i potencialeve (natyrës) individuale të çdo fëmije – zhvillim sipas, nevojave individuale ( zhvillim personal, socio-emocional, fizik, intelektual, gjuhësor dhe krijues).*

*Filozofia e kurikulës së edukimit parashkollor:*

- *Edukimi i fëmijëve të grup-moshës deri në tri vjeç dhe i grup-moshës deri në gjashtë vjeç, konsiston në zhvillimin e aspektit shëndetësor e fizik, emocional, ndijor, mendor e social;*
- *Nga se aspektet e personalitetit fillojnë të zhvillohen që në fëmijëri të hershme e vazhdojnë të zhvillohen në periodat pasuese jetësore;*
- *Për këtë shkak nuk arsyetohet tendenca e anashkalimit të procesit edukativ në grup-moshën deri në tri vjeç dhe e identifikimit të këtij procesi me kujdesin shëndetësor dhe mirërritjen e fëmijës;*
- *Kjo tendencë nuk ka mbështetje shkencore, andaj si e dëmshme për fëmijët parashkollor, nuk bën të jetësohet në praktikën edukative në Kosovë.*

*Filozofia e edukimit parashkollor afirmon domosdoshmërinë e bashkëveprimit reciprok e të ngushtë të përbërësve brenda faktorëve edukativ (faktorëve brendapërbrenda familjes apo faktorëve brendapërbrenda institucionit parashkollor) dhe ndërmjet faktorëve të ndryshëm, por gjithnjë duke i respektuar specifikat e edukatës familjare.*

*Fëmija dhe të rriturit duhet të kuptojnë se të nxënit është proces shumë kahor gjatë të cilit fëmijët mësojnë nga njëri tjetri, mësojnë nga të rriturit, por edhe të rriturit mësojnë nga fëmijët. Ka rrugë të ndryshme për tu arritur një qëllim dhe pikërisht për këtë duhet, jo t'iu imponohet fëmijëve idetë apo zgjedhjet, por të inkurajohen, të provojnë të bëjnë diçka të re, dhe idetë e përvojat e tyre ti këmbëjnë me të tjerët.*

*Një segment i pashmangshëm i filozofisë së edukimit parashkollor është mbështjta-përforcimi pozitiv i fëmijës, që nënkupton të përqendruarit në sjelljet e mira dhe tiparet pozitive të fëmijës, që si rrjedhojë ka dëshirën dhe angazhimin e fëmijës të bëhet i mirë.*

*Filozofia e edukimit parashkollor synon inkurajimin e zhvillimit tërësor të personalitetit të fëmijës, të nevojshëm për fëmijën që të sfidohet dhe ti sfidojë ndryshimet të cilat sot zhvillohen me shpejtësi.*

*Parimet themelore të edukimit parashkollor:*

- *Edukimi parashkollor i institucionalizuar është hallka e parë e sistemit arsimor dhe realizohet në institucionet parashkollore;*
- *Institucionet parashkollore realizojnë edukimin dhe mirëritjen e fëmijëve parashkollorë;*
- *Institucionet parashkollore realizojnë veprimtarinë e tyre në bashkëveprimin me familjen, komunitetin dhe institucionet përgjegjëse;*
- *Partneriteti i familjes, institucioneve parashkollore dhe komunitetit siguron harmonizimin dhe vazhdimësinë e edukimit të fëmijës (parimi i kontinuitetit horizontal);*
- *Institucioni parashkollorë veprimtarinë edukative e mbështet në përvojën dhe*

*kontekstin familjar të fëmijës;*

- *Veprimtaria edukative nuk ndahet prerazi në grup-mosha, por realizohet në vazhdimësi graduale e të ndryshme nga grup-mosha në grup-moshë (parimi i kontinuitetit vertikal);*
- *Në qendër të veprimtarisë edukative të institucioneve parashkollore është fëmija me individualitetin (mundësitë, nevojat, interesat, etj) dhe intimitetin e tij.*
- *Fushat e aktiviteteve, për çdo grup-moshë, janë të integruara e të ndërlidhuara dhe synojnë realizimin e qëllimeve të përbashkëta të edukimit parashkollor.*
- *Fëmija parashkollor mëson, aftësohet e shkathtësohet përmes përmbajtjeve të strukturuar.*
- *Fëmija parashkollor, aftësohet e shkathtësohet edhe përmes jetës bashkëvepruese në institucionin parashkollor.*
- *Loja është veprimtari përmes së cilës realizohet edukimi i institucionalizuar parashkollor i fëmijës.*
- *Edukimi parashkollor i institucionalizuar veprimtarinë edukative e mbështet dhe e realizon edhe mbi situatat e natyrshme jetësore të fëmijës.*
- *Institucionet parashkollore janë demokratike, ofrojnë shanse të barabarta të edukimit për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga përkatësia gjinore, etnike, fetare, racore etj.*
- *Institucionet parashkollore janë të hapura dhe sigurojnë edukim edhe për fëmijët me nevoja të veçanta.*
- *Prindërit duke respektuar edhe dëshirat dhe nevojat e mundëshme të fëmijës, zgjedhin programin edukativ për fëmijën e tyre.*
- *Në institucionet parashkollore edukatorja-i përmbush përgjegjësinë pedagogjike të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë edukative në përshtatje me nivelin e zhvillimit të fëmijëve parashkollor.*
- *Institucionet parashkollore zhvillojnë veprimtari edukative të programuar që mund të realizohet përmes metodologjive të ndryshme bashkëkohore.*
- *Institucioni parashkollor është fleksibil, i hapur dhe i gatshëm për ndryshime të favorshme për edukimin e fëmijëve parashkollorë.*



**UNIVERSITETI AAB**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE**

Departamenti i Përkujdesjes dhe Mirëqenies së  
fëmijëve

Lënda: **Metodikë e Mësimdhënies**

**Ligjerata VIII**

**Tema: Metodatat e të mësuarit me fëmijën në  
qendër**  
(skica ligjerimi)

**Mësimdhënsi: Prof.dr. Fadbi Osmani**

## **Karakteristikat kryesore të metodologjisë me fëmijën në qendër:**

- fëmijët kanë stile të ndryshme të të nxënit;
  - çdo fëmijë ka stilin e vetë të të nxënit;
  - çdo fëmijë ka nevoja dhe interesa individuale;
  - fëmijët kanë nevojë për shprehje dhe koncepte të ndryshme;
  - formimi i shprehjeve dhe koncepteve të ndryshme gjithmonë kërkon mjedis të pasur për të nxënë, por jo vetëm kaq;
  - çdo mjedis i pasur duhet të përcjellat me metoda dhe teknika si dhe materiale të veprimitarisë edukative.
- 
- metoda me fëmijën në qendër zë një vend të rëndësishëm dhe të natyrshëm në edukimin parashkollor;
  - veprimtaria edukative që realizohet brenda ose jashtë institucionit parashkollor (kopsht) është proces ndërveprues;
  - në këtë proces, mësuesja (edukatorja) dhe fëmijët bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë për një qëllim të caktuar.

## **Në kuptim më të ngushtë Metoda me në qendër fëmijën nënkupton:**

- kur edukatorja –mësuesja, krijon mundësi, dhe i le fëmijët që shumë natyrshëm të zbulojnë mjedisin sipas mënyrës së tyre;
- kur fëmijët zgjedhin vetë veprimtarinë dhe veprimet që duhet ti kryejn;
- kur fëmijët luajnë vetëm me një ose më shumë fëmijë, në grupe të vogla, dhe përdorin materiale dhe mjete në mënyra të ndryshme, e sipas dëshirave të tyre.

*Metoda me në qendër fëmijën, zakonisht në ato raste kur edukatorja, njeh zhvillimin e fëmijëve, njohuritë që ata zotërojnë, dhe në mënyrë të qëllimshme i le të veprojnë të pavarur.*

### **Në përdorimin e kësaj Metode duhet të kemi parasysh:**

- vendosjen e paisjeve të përshtatshme, zgjedhjen e materialeve të shumta didaktike, tërheqëse dhe interesante për fëmijët etj;
- edukatorja-mësuesja, duhet të dijnë si ti motivojnë fëmijët, si ti orientojnë dhe ti drejtojnë në veprime praktike, sepse kjo mundëson të nxënit ( të lehtësohet të nxënit).

### **Metoda me në qendër “ edukatoren-mësuesen”, nënkupton:**

- të nxënit e drejtëpërdrejtë, sepse jo të gjitha përvojat e fëmijëve që fitojnë atë i drejtojnë drejt të nxënit e kuptueshëm.

### **PRA:**

- Kjo metodë, përfshin atë lloj planifikimi i cili do të mundësojë si do tu mësohet fëmijëve një koncept apo një shprehje e caktuar;
- cilat do jenë materialet e nevojshme, çfarë duhet tu mësohet fëmijëve individualisht, në grupe të vogla ose e gjithë klasa.

### **Cili është roli i edukatores në përdorimin e metodave të nxënies:**

- Edukatorja luan (ka) rolin e mbështetëses, vëzhgueses, drejtueses, lehtësueses në procesin e nxënies, dhe ajo:
- planifikon veprimtari të larmishme, duke përdor materiale të ndryshme, për të

nxitur dhe për të zhvilluar te fëmijët ndërthurje të veprimeve të shqisave, shprehi sociale, aftësi krijuese shprehje të mendimeve, të ideve dhe interesim për të nxënë.

- nxit zhvillimin gjuhësor dhe besimin e fëmijëve në aftësitë e tyre, nëpërmjet tregimeve dhe diskutimeve të ndryshme;
- nxit fëmijët të bëjnë pyetje dhe të hulumtojnë në mjedisin që i rethon;
- vëzhgon fëmijët për të regjistruar dhe vlerësuar përparimin e tyre, dhe u jep prindërve udhëzim për punën e tyre të mëtejshme;
- përfshin (integron) fëmijët me aftësi të kufizuar.
- diskuton me prindërit për aspekte të ndryshme të zhvillimit të fëmijëve;
- trajton me fëmijët dhe prindërit çështjet e mbrojtjes, të sigurisë, shëndetit mendor e fizik;
- respekton dhe mbështet çdo fëmijë-respekton diversitetin e fëmijëve;
- gjenë hapsira dhe mundësi për punë me fëmijë që kanë nevoja të veçanta etj.

*Mos u shqetësoni nëse fëmijët nuk ju dëgjojnë. Ju shqetësohuni kur ata gjithmonë  
Ju shohin vetëm juve.*

**UNIVERSITETI AAB**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE**  
*Departamenti i Përkujdesjes dhe Mirëqenies*  
*së fëmijëve*

*Lënda: Metodikë e Mësimdhënies*

***Ligjerata IX***

***Tema: Metodat e zhvillimit të fëmijërisë së***  
***hershme***  
***(skica ligjerimi)***

***Mësimdhënsi: Prof.dr. Fadbi Osmani***

*Kuptimi mbi metodat e zhvillimit të hershëm:*

- *metodat paraqesin çështjen e organizimit në procesin e nxënies;*
- *element dhe tregues cilësor i punës së mësuesit;*
- *faktor të rëndësishëm për efektshmëri në procesin e nxënise;*
- *metodat krijojnë ambient stimulues;*
- *metodat e përshtatshme nxisin, stimulojnë fëmijën të komunikojnë me të mësuar;*
- *metodat mundësojnë procesin e njohjes mësimore;*
- *metodat ndihmojnë për aritjen e qëllimeve;*
- *metodat lehtësojnë përvetësimin e njohurive, fitimin e shprehive, të aftësive (shkathtësive) dhe realizimin e detyrave të caktuara.*

*Të mësuarit nëpërmjet lojës është mënyra sipas së cilës fëmijët mësojnë, prandaj metodat dhe teknikat që zgjedh edukatorja për ti përdor me fëmijët në fushat e vperimeve të ndryshme, duhet të jepen në formën e lojës.*

*Metodat të cilat më së shumti gjejnë zbatim në zhvillimin e hershëm janë:*

- *Biseda;*
- *Demonstrimi;*
- *Shpjegimi;*
- *Ekskursioni;*
- *Të pyeturit;*
- *Diskutimi;*

*Biseda, është metoda nëpërmjet së cilës edukatorja-mësuesja, zakonisht i fton fëmijët të flasnin rreth një teme ose çështje të caktuar, të shkëmbejnë mendime dhe informacione me njëri tjetrin;*

- *biseda përdoret më së shumti për përvetësim të njohurive dhe koncepteve të reja;*
- *në përgjithësi biseda drejtohet nga edukatorja, dhe bënë pjesë në kuadër të*

*metodave tradicionale, por mjaft efektive për zhvillimin e moshës parashkollore;*

- *biseda që zhvillon mësuësja duhet mirë të jetë strukturuar, sepse atëherë ajo ka sukses në realizimin e qëllimit të saj.*

*Biseda mund të zhvillohet për tema të ndryshme, por, gjat përdorimit të kësaj metode duhet gjithmonë të kemi parasysh që biseda të mos përqëndrohet në një grup të vogël fëmijësh.*

*Ajo duhet të përfshijë të gjithë fëmijët.*

*E një rëndësie të veçantë për edukatoren është:*

- *që biseda gjegjësisht, drejtimet dhe çështjet kryesore të bisedës të përgatiten paraprakisht, pavarësisht se ajo mund të mbështetet dhe ta ndryshoj planin e bisedës nga idetë apo mendimet që i japin fëmijët.*

*Shpjegimi, si metodë synon shpërndarjen e informacionit tek fëmijët sipas nevojave që ato paraqesin.*

*Shpjegimi bënë pjesë në kuadër të metodave, ku mësuësja është në qendër. Fëmijët duke qenë në reolin e dëgjuesit janë pasiv, prandaj gjatë zbatimit të kësaj metode preferohet që mësuësja kur vëren shenja lodhje, atëherë duhet të ndroj stilin e shpjegimit dhe të fus elemente dhe ushtrime që i çlodhin fëmijët.*

*Demonstrimi, si metodë ka për qëllim të ilustroj një çështje, koncept me shembuj konkret.*

*Zakonisht nisja bëhet me përshkrimin e asaj që do të demonstrohet, duke dhënë momentet kryesore ku duhet të përqëndrohet vëmendja e fëmijëve, sepse fëmijët e moshës së hershme mësojnë më mirë duke parë, duke vëzhguar dhe duke vepruar.*

*Ekspursionet, është metodë e veçantë në nxënie kur fëmijët kanë mundësi të njohin objekte, dukuri, procese që i përkasin mjedisit natyror, të shetisin, të bëjnë vizita të organizuara dhe me tematikë të caktuar.*

*Të pyeturit, paraqet metodë mjaft efektive në nxitjen e të menduarit, të arsyetuarit dhe të zgjedhjes së problemeve. Bërja e pyetjeve dhe rrjedha e përgjigjeve, nxitja për të bërë pyetje paraqet një çështje shumë të rëndësishme, sepse fëmijët janë shumë kureshtar në të bërit pyetje etj.*

*Aftësia e të pyeturit, nga fëmijët shfrytëzohet në çdo veprimtari që zhvillohet. Mësuesja gjithmonë duhet të nxisë fëmijët të bëjnë pyetje rreth asaj që shikojnë, dëgjojnë, që thonë të tjerët-të riturit. Përgjigjet duhet të meren nga fëmijët e tjerë, atherë kur ata nuk mundën të japin përgjigje, atherë me të drejtë inkuadrohet mësuesja për të dhënë përgjigje.*

*Diskutimi, paraqet një metodë apo procedur, por mund të llogaritet edhe si teknikë mësimore, ku mësuesja dhe fëmijët diskutojnë me njëri-tjetrin, rreth një çështje të caktuar. Në zbatimin e diskutimit, mësuesja duhet të mbaj nën kontroll rrjedhën e diskutimit sepse fëmijët lehtë mund të dalin jashtë temës, ose të mos kuptojnë thelbin e bisedës etj.*

*Se me të vërtetë metodat dhe teknikat mësimore janë shumë të rëndësishme, flet fakti se ato me mjeshtri duhet të përdoren, sepse përdorimi adekuat i tyre padyshim rrit efektivitetin e punës edukative dhe mësimore:  
Në këtë drejtim dë të shërbehemi me thënjen:*

*“Nëse një fëmijë nuk është duke mësuar me metodën që ju po përdorni, atherë ju takon juve ti përshtateni stilit të tij të të nxënit”*



**UNIVERSITETI AAB**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE**  
Departamenti i Përkujdesjes dhe  
Mirëqenies së fëmijëve

Lënda: **Metodikë e Mësimdhënies**

**Ligjerata X-XI**

**Tema: Teknikat e zhvillimit të fëmijërisë  
së hershme dhe mjedisi i të nxënit  
(skica ligjerimi)**

**Mësimdhënsi: Prof.dr. Fadbi Osmani**

***Në procesin e të nxënit, mësuesja-edukatorja vepron me:***

- ***Metoda*** për aritjen e qëllimeve, lehtësimin në përvetësimin e njohurive, fitimin e shprehive dhe zhvillimin e aftësive-shkathtësive;
- ***Strategji***, që paraqet rrugën, drejtimin që edukatori e realizon në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.  
(qëllimi...struktura...përmbajtja...ecuria...rezultati)
- ***Teknikat***, paraqesin procedurat për të realizuar qëllimet nëpërmjet metodave të caktuara.

***Zbatimi i teknikave dhe strategjive mundësojnë realizimin e këtyre qëllimeve:***

- nxitjen e fëmijëve në zhvillimin, e në drejtim gradual të formimit të të menduarit të mirfillit;
- nxitjen për të debatuar për temë të caktuar, e me qëllim të zgjerimit të njohurive;
- nxitjen e fëmijëve për tu aftësuar që në mënyrë të vetëdijshme të bashkëpunojnë me të tjerët;
- nxitjen e fëmijëve për tu aftësuar për të debatuar me të tjerët, me qëllim që të mbrojnë qëndrimet e tyre.

***Ndër teknikat më të preferuara që mundësojnë zhvillimin e fëmijëve janë:***

**1. Stuhia e mendimeve:** paraqet një teknikë në mbledhjen e ideve dhe mendimeve rreth një teme që diskutohet;

- zakonisht fëmijëve u jepet (drejtohet) një pyetje, ose një fjalë kryesore, e ata më pastaj japin të dhëna dhe ide si e kuptojnë atë;

- gjatë zbatimit të kësaj teknike, mësuesja nuk preferohet të japë vlerësime për përgjigjet që japin fëmijët, as edhe kur përgjigjet janë të gabuara.

Shembuj në zbatimin e teknikës **“Stuhi idesh”**

a) çfar ndodh në:

DIMËR

b) çfar dini për kafshët shtëpijake

QENI,MACJA etj.

**2. Pema e mendimeve:** paraqet një teknikë më komplekse e cila i nxit fëmijët të japin ide dhe informacione të lidhuara ndërmjet tyre, në veçanti kur bëhet fjalë për tema më të gjera; për tema si: “Stinët”, “Atdheu”, “Trupi i njeriut”, “Të drejtat e fëmijëve” etj.

◦ Shembull në zbatimin e teknikës **“Pema e mendimeve”**

PRANVERA

VERA

STINËT

DIMRI

VJESHTA

**3. Pesvargëshi:** ka për qëllim të përgjithësoj idetë e diskutimeve me fëmijët reth një çështje të caktuar, pra pesë vargjet:

1. në vargun e parë shkruhet tema ose një emër.
2. në vargun e dytë shkruhen dy mbiemra që tregojnë cilësinë e emrit.
3. në rethin e tretë shkruhen 3 folje.
4. në rethin e katërt shkruhen një fjali me 3-4 fjalë.
5. në rethin e pestë shkruhet fjala sinonime me emrin e dhënë në rethin (vargun) e parë.

***Shembulli për “pesvargëshin”***

- Tema:.....Unë
- Si je ti? .....i mirë i dashur
- Çfar bën ti në klasë?.....luaj, pastroj, mësoj
- Kush thot një fjali për veten?.....Në kopsht unë kënaqem shumë
- Çfar je ti.....Djal-Vajz

**4. Diagami i VEINT:** përdoret si teknikë në rastet kur duhet të krahasohen dy personazhe, pralla, objekte, lojra etj. Pra qëllimi është që përmes kësaj teknike të identifikoj anët e përbashkëta dhe dallimet ndërmjet personazheve, sendeve e objekteve që krahasohen.

***Shembulli i diagramit të Venit:***

Të veçantat e... Të përbashkëtat e... Të veçantat e...

Personazhe

Personazhe

Personazhe

### **Mjedisi i të nxënit paraqet:**

- një nga kushtet kryesore për mënyrën e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve;
- mjedisi për zhvillim dhe nxënie duhet të jetë i qetë, fëmijët të ndjehen rehat, me hapsira të mjaftueshme, në të cilat fëmijët mund të kërkojnë, të zbulojnë dhe të krijojnë.

### ***Mjedisi i të nxënit dhe zhvillimi i fëmijëve përfshinë:***

- mjedisin fizik;
- regjimin ditor;
- atmosferën sociale;

***Mjedisi fizik:*** nënkupton mjediset e brendëshme dhe të jashtme të institucionit parashkollor (mjedise për fjetjen e fëmijëve, mjediset e toaletit, mjediset për të ngrënë, për veshje personale, obor etj.

### ***Mjedisi (regjimi) ditor nënkupton:***

- pritjen e fëmijëve;
- biseda e mëngjesit;
- veprimtari të ndryshme të grupeve;
- veprimtari në qendra të ndryshme;
- kohët e ushqimit;
- koha e pushimit (fjetja);
- largimi (përcjellja) për në shtëpi;

***Atmosfera sociale nënkupton:***

- Krijimin e mardhënieve pozitive ku fëmijët mësojnë shprehjet e zgjidhjes së problemeve, nëpërmjet edukatores, e cila përdor strategji të ndryshme për të përballuar sjelljet që paraqesin fëmijët, dhe për të mbajtur nën kontroll situatën.

**UNIVERSITETI AAB**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE**  
Departamenti i Përkujdesjes dhe  
Mirëqenies së fëmijëve

Lënda: **Metodikë e Mësimdhënies**

**Ligjerata XII-XIII**

**Tema: Modelet dhe programet për  
edukimin parashkollor dhe vlersimi i  
fëmijëve  
(skica ligjerimi)**

Mësimdhënsi: **Prof.dr. Fadbi Osmani**

*Në përvojën dhe zhvillimin historik të kopshteve janë të njohura programe, modele dhe metoda të cilat janë studiuar dhe janë praktikuar nga edukatorët, fëmijët, prindërit dhe komuniteti.*

*Në vazhdim do ti përmendim disa nga modelet kryesore në bazë të të cilave punojnë kopshtet*

### **MODELET KRYESORE NË BAZË TË TË CILËVE PUNOJNË KOPSHTET:**

- Modeli i Frebelit;
- Modeli i Montesorit( Maria Montesori);
- Modeli tradicional ( metoda me edukatoren në qendër);
- Modeli Rexhio Emilio(modeli Italian);
- Modeli apo programi Hap pas Hapi( metoda me fëmijën në qendër);
- Modeli i kopshteve që punojnë me standarde;

### **EDUKIMI NË KOPSHTIN E FËMIJËVE SIPAS MODELIT TË FREBELIT MBËSHTETET NË TRI PARIME KRYESORE:**

- zhvillimi i fëmijës duhet të jetë i natyrshëm;
- zhvillimi duhet të realizohet në mënyrë graduale;
- zhvillimi duhet të bëhet nëpërmjet veprimtarive të pavaruara të fëmijës;

### **KUJTO: Thelbi i metodës së Frebelit është:**

***“Të mësuarit nëpërmjet lojës”***

- Sipas Frebelit fëmija e njeh botën, e krijon dhe e zhvillon duke u ballafaquar me gjërat dhe sendet;
- fëmijët duhet të nxiten, të shprehen lirshëm nevojat dhe ndjenjat e



brendëshme;

- fëmijët sipas këtij modeli e njohin natyrën duke kaluar nga më e thjeshta ka më e vështira, nga konkretja te apstraktja; nga e njohura te e panjohura;

### **KARAKTERISTIKAT E MODELIT TË MONTESORIT JANË:**

- fëmijët mësojnë më mirë duke bërë diçka, duke i prekur objektet , duke i prekur, duke i nuhatur ato, në kopsht duhet më pak lodra e më shumë objekte nga jeta e përditshme;
- fëmijët duhet të përdoren materiale didaktike të cilët duhet të jenë në funksion të zhvillimit të mendjes, zhvillimit të shqisave, zhvillimi fizik, edukimi muzikor;
- fëmijët duhet zhvilluar duke mësuar nga njëri tjetri fëmijët e vegjël ndjekin punën e fëmijëve më të rritur;

### **PROCESI I MËSIMIT TEK FËMIJËT NË KOPSHT KALON NËPËR KËTO FAZA:**

- të dëgjuarit;
- të vërejturit;
- të zbuluarit;
- të praktikuarit;
- përgjegjësia për të kryer një veprimtari

### **KARAKTERISTIKAT E MODELIT TË KOPSHTIT TË REXHIO EMILIOS JANË:**

- zhvillimi i aftësive krijuese tek fëmijët nëpërmjet arteve të bukura( muzika, vizatimi dhe dramatizimi);
- baza e këtij modeli është :”të nxënit duke bërë”;
- zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit bazohet në interesat e fëmijës;
- modeli i Rexhi Emilios në esencë ka formimin e personalitetit te fëmijës( formimi social, zhvillimin e intelegjencës dhe shprehjet gjuhësore)

## **PROGRAMI( MODELI) “HAP PAS HAPI” PËRFSHIHET NGA KËTO ELEMENTE:**

- fëmijët duhet të jenë të lirë dhe të kalojnë prej një veprimtarie në tjetrën;
- programi “hap pas hapi” mbështillet në teorinë zhvilluese;
- fëmijët mund të luajnë në mënyrë individuale ose në grupe të vogla;
- fëmijët formojnë konceptet(kuptimet) nëpërmes këngëve dhe lojarave;

## **MODELI I KOPSHTIT TRADICIONAL KA PËR QËLLIM:**

- realizimin e detyrave nga procesi njohës, e jo plotësimi i nevojave dhe interesave të fëmijës;
- të gjithë fëmijët irealizojnë detyrat e njejta dhe fitojnë të njejtat aftësi, duke mos marrë parasysh ritmet individuale të secilit prej tyre;
- fëmijët janë të detyruar të plotësojnë detyrat brenda kohës së caktuar;
- vlerësimi i fëmijës bëhet mbi bazën e standardeve të përcaktuara nga të rriturit;

## **KARAKTERISTIKAT E KOPSHTIT QË PUNON ME STANDARDE JANË:**

- organizimi dhe rregullimi i mjedisit në funksionon të veprimtarive që zhvillohen në kopsht;
- mësuesja- edukatorja është e lirë dhe ka hapësirë në mënyrë profesionale të planifikoj zhvillimin e veprimtarisë edukative;
- perqëndrimi i vëmendjes në dëshirat dhe karakteristikat e zhvillimit të fëmijëve;
- sigurimi i kushteve teknike –hapsinore dhe sigurimi i materialeve, pajisjeve dhe mjeteve didaktike;
- aftësimi(trajnimi ) i vazhdueshëm i personelit edukativ dhe menaxhues të kopshtit;

- pjesëmarrja aktive e prindërve e fëmijëve;
  - palnifikime cilësore vjetore, mujore dhe ditore;
- Komunikimi me fëmijët:

### **Roli i vlerësimit në fëmijërinë e hershme:**

- fëmijëria e hershme është koha e ndryshimeve të mëdha dhe të shpejta;
- është e pamundur të bëhet vlerësimi i programit të edukimit pa iu referuar kurikulës që zhvillohet më tej;
- vlersimi ka rëndësi të veçant, sepse ai mundëson mbledhjen e informacionit rreth zhvillimit të fëmijëve, e këto të dhëna do ju shërbejnë prindërve, edukatorëve, drejtuesve të informacionit parashkollor, hartuesvë të programeve parashkollor dhe të tjerëve.

### **Vlerësimi në fëmijërinë e hershme synon:**

- evidentimin se programi edukativ ka realizuar qëllimet dhe objektivat në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve;
- të ballafaqohet programi me rezultatet e fëmijëve;
- të identifikoj aspektet të programit që duhet përmirësuar;
- të verifikoj nevojat e stafit edukativ për kualifikim;
- të ngrej iniciativa për përpilimin e programeve dhe të planeve individuale për fëmijë me nevoja të veçanta.

### **Vlerësimi i fëmijëve nënkupton:**

- vlersimin e zhvillimit të hershëm, në ndërtimin e njohurive nëpërmjet ndërveprimit, objektiv konkret, dhe punës me dorë;
- vlersimi në fëmijërinë e hershme kryhet mbi bazën e vëzhgimeve për punët e kryera, dokumentacionit të mbrojtur, analizës dhe rishikimit të punës së zhvilluar

nga fëmijët;

- vlersimi duhet të jetë përfitues për fëmijët, të jetë i besueshëm, i kuptueshëm etj.